

**URDHËR**  
**Nr. 209, datë 12.4.2021**

**PËR NJË NDRYSHIM NË URDHRIN NR. 99, DATË 10.2.2021,**  
**“PËR KUFIZIMIN E LËVIZJES BRENDA VENDIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 7, pika 4, germa “d”, të ligjit nr. 15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, sipas udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik, në zbatim të vendimit të Komitetit të Përkohshëm për Infeksionin e Përhapur nga Coronavirus i ri nr. 809/8, datë 11.4.2021, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19,

**URDHËROJ:**

Në urdhrin nr. 99, datë 10.2.2021, “Për kufizimin e lëvizjes brenda vendit”, të ndryshuar, bëhet ndryshimi si vijon:

1. Pika 1 e urdhrin riformulohet si më poshtë vijon:

“Kufizimin e lëvizjes së popullatës nga ora 22:00 deri në orën 06:00, në të gjithë vendin, nga data 12.4.2021 deri në një urdhër të dytë.”.

2. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE**  
**Ogerta Manastirliu**